



Pranuar / Dorezuar Punjenor/Prodoto Received/Delivered	12.07	2023	3	viti god Year
Organ /Rjeshta Organ /Jedinita Org./Unit	Nr. Prot Pr. No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSCHCK	5171	2023	13	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.814/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.814/2023 të datës 05.06.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë: Komuna e Pejës, kundër organit të punësimit/Komuna e Pejës, në çështjen juridike *kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 12.07.2023 mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.814/2023 e datës 05.06.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Pejës sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit me numër të protokollit A.Nr.724/2022 të datës 12.10.2023 në pozitën e punës *“Udhëheqës i Zyrës për Informim”*, më datë 02.05.2023 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Zyrës së Personeli në Komunën e Pejës përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e të ardhurave nga paga në bazë të koeficientit adekuat për udhëheqës Njësie/Sektor. Menaxheri i Burimeve Njerëzore më datë 01.05.2023 përmes përgjigjes në kërkesë me numër të referencës 01-400/01-0049851/23 ka njoftuar ankuesin që i është refuzuar kërkesa e datës 02.05.2023 lidhur me kompensimin e pagave.

Ankuesi i pa kënaqur me përgjigje në kërkesë nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore më datë 05.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4591/2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,

duke kërkuar që të obligohet Komuna e Pejës të bëjë kompensimin e koeficientit nga shtatë pikë pesë (7.5) në atë tetë pikë pesë (8.5) për periudhën 10.11.2014 deri më datë 12.10.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 09.06.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Pejës. Ndërsa Këshilli më datë 13.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesa e parashtruar nga ankuesi përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net me numër protokollit 4591/2023 e datës 05.06.2023; Përgjigje në kërkesë me numër reference 01-400/01-0049851/23 e datës 01.06.2023; Kërkesë e datës 02.05.2023; Vendim me numër A.nr.724/2022 i datës 12.10.2022 nga KPMSHCK; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 09.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 12.06.2023; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit me numër A.Nr.724/2022 i datës 12.10.2023; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës; Shkresë për Ndryshim dhe Plotësim të Akt Emërimit e datës 09.10.2023; Konkurs Intern; Listë nga Komuna e Pejës; Kërkesë për rritje të koeficientit me numër Nr.01 e datës 29.07.2022; Formulari i të dhënave për listën e pagave i datës 03.11.2022; E-mail i datës 20.10.2022; Liste e pagave e datës.

Kolegji i Këshillit pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e palejuar, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që t'i njihet e drejta e kompensimit në mënyrë retroaktive i shumës së papaguar të pagave nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në atë tetë pikë pesë (8.5) për periudhën 10.11.2014 deri më datë 12.10.2022 dhe atë për 96 muaj në lartësinë e ndryshimit të koeficientit për shumën (60.50) euro në muaj, si dhe kontributet tjera që kanë të bëjnë me përvojën e punës në këtë periudhë.

Kolegji i Këshillit shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin në mënyrë retroaktive të diferencës së koeficienteve, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi nga data 12.10.2023 është caktuar në pozitën e punës "Udhëheqës i Zyrës për Informim", ku ka realizuar koeficient tetë pikë pesë (8.5) të pagës dhe se e njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 02.05.2023 (data e parashtrimit të kërkesës tek Udhëheqësi i Personelit në Komunën e Pejës), rrjedhimisht ankuesi nuk e kishte kundërshtuar Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit Emërimit me numër të protokollit A.Nr.724/2022 të datës 12.10.2023 në kuptim të koeficientit të pagës, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (ligj i aplikueshëm në kohën e lëshimit dhe nënshkrimit të Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 01.02.2019), përkatësisht nenin 127 paragrafi 1 të këtij ligji ku përcaktohet se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", andaj mbi këtë bazë rrjedh se ankesa e ankuesit është palejueshme.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.814/2023

Kaltrina Aydullakfi-Prenaj


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi'
- Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Pejës ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;

